**Qendra YES** është krijuar me mbështetjen e projektit **"Perspektiva të Reja"** i cili zbatohet nga **Swisscontact** në bashkëpunim me **TAG International**, dhe financohet nga **Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar** nëpërmjet Ambasadës Britanike në Tiranë.

## Informacione rreth kontakteve të projektit “Perspektiva të Reja”:

Vendndodhja: **Rruga e Turizmit të ri, L. 5, Kukës, Shqipëri.**
Telefon: **+355 69 60 61 186**
Email: **info.np@swisscontact.org**
Facebook: **Perspektiva të Reja - New Perspectives**
Instagram: **perspektiva_te_reja**

## Youth Entrepreneurship Space

Qendra YES ndodhet në katin e 2-të të Pallatit të Kulturës “Hasan Prishtina” në qendër të qytetit të Kukësit.

UKaid from the British people

swisscontact TAG International

PERSPEKTIVA TË REJA

# Youth Entrepreneurship Space

## Çfarë është Qendra YES?

Si pikë thelbësore e qytetit përsipërmarrjen dhe inovacionin, YES është një qendër për zhvillim ekonomik vendor që bashkon të rinjtë, studiuesit, krijuesit, bizneset dhe novatorët për të krijuar dhe ushqyer idetë dhe për t'i transformuar ato në produkte dhe shërbime që mund të shiten dhe të gjenerojnë të ardhura.

## Misioni:

Misioni i Qendrës YES është të krijojë një mjedis të favorshëm dhe inkurajues për inovacionin dhe lidhjet produktive që ndikojnë në suksesin e sipërmarrësve privatë dhe institucioneve publike, në nivelin ekonomik dhe profesional të komunitetit.

## YES do t'u ofrojë mundësi grupeve të ndryshme për:

1 **Realizim**
programesh të ndryshme aftësimi profesional dhe teknik të përshtatura rreth nevojave të zhvillimit ekonomik vendor.

2 **Krijim**
mundësish bashkëpunimi për të çuar përpara të reja sipërmarrëse.

3 **Mbështetje**
për sipërmarrësit e rinj dhe kompanitë me përvojë të kenë akses në shërbime dhe burime që u nevojiten për të sjellë risi në treg.

## Roli i projektit "Perspektiva të Reja" në krijimin e Qendrës YES, në bashkëpunim me Bashkinë:

- Ofron shërbime për funksionimin e YES, si dhe miraton rregulloren e funksionimit të saj.
- Mundëson një mjedis inkurajues për tërheqjen e talenteve dhe frymëzimin e të rinjve, bizneseve dhe qytetarëve për të shfrytëzuar potencialin e plotë të Qendrës;
- Prioritizon barazinë gjinore duke ofruar perspektiva zhvillimi për të gjithë, në një mjedis neutral që është i orientuar drejt inovacionit dhe përmirësimit të kushteve socio-ekonomike.
- Lehtëson bashkëveprimin midis të rinjve, bizneseve, institucioneve dhe organizatave vendase, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit dhe zhvillimit ekonomik vendor.